

Në Prishtinë, më 23 shkurt 2022
Nr. Ref.: 160/3

Në mbështetje të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Ligji Nr. 05/L-038, neni 14 dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2, të 11.05.2016, neni 17 dhe 30, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 shkurt 2022, nxori këtë

RREGULLORE PËR HONORARËT E AUTORËVE TË VEPRIMTARISË BOTUESE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Neni 1

1. Rregullorja përcakton standardet dhe kriteret për lartësinë e honorarëve të autorëve të veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.
2. Për zbatimin e standardeve dhe kriterëve të honorarëve të autorëve të dorëshkrimeve është përgjegjës Këshilli botues, i cili përbëhet nga Sekretari shkencor, që është kryesues i tij, dhe nga sekretarët e seksioneve.

Neni 2

1. Honorarët e autorit për vepra shkencore, vepra letrare, vepra muzikore dhe vepra arti llogariten me tabak autori:
 - 1.1. Tabaku i autorit për vepra shkencore dhe vepra letrare konsiderohet teksti prej 24 mijë shenja shtypi/kompjuterike pa zbrazëtira (space), përfshirë indeksin, bibliografinë, shpjegimi i shkurtesave, simboleve dhe fjalorin shpjegues të fjalëve të panjohura;
 - 1.2. Tabaku i autorit për vepra shkencore me formula, diagrame, harta, fotografi, tabela, etj. llogaritet me 16 faqe në të gjitha formatet e botimeve të ASHAK-ut;
 - 1.3. Tabaku i autorit për vepra muzikore përbëhet prej 16 faqesh në të gjitha formatet e botimeve muzikore të ASHAK-ut; dhe
 - 1.4. Tabaku i autorit për vepra arti përbëhet prej 16 faqesh në të gjitha formatet e botimeve të arteve pamore të ASHAK-ut.
2. Honorarët e autorit për vepra letrare në poezi llogariten me vargje.
3. Honorarët e monografive të krijuesve të veprave të artit i llogariten autorit të tekstit të dorëshkrimit dhe artistit të prezantuar sipas tabakut të autorit për vepra arti, paragrafi 1.4. i këtij neni, në raport 50/50 secilit.
4. Honorari i katalogëve të ekspozitave personale dhe të përbashkëta i llogariten autorit të tekstit të parathënies.
5. Honorarët e punimeve shkencore të cilat botohen në revistat e ASHAK-ut llogariten vetëm për autorët me llogari bankare në ndonjërin nga Bankat që veprojnë në Kosovë.
6. Listën e autorëve të punimeve të cilat botohen në revistat e ASHAK-ut dhe që duhet paguar honorari i autorit e përcakton Këshilli redaktues i revistës, në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni.
7. Për projekte të veçanta autorët dhe redaktorët e teksteve dhe të botimeve kompensohen me vendim të veçantë të Kryesisë.

Neni 3

1. Honorari për tabak autori paguhet:
 - 1.1. Për punime origjinale 180€;
 - 1.2. Për përgatitjen e botimeve kritike (që përfshin komentet, bibliografitë, indeksi i emrave, shënimet, përgatitjen dhe kritikën e teksteve, të gjitha punët e nevojshme kur ato i kryen përgatitësi i tekstit, aparatit kritik, tabelat, transkriptimet-transliterimet dhe mjetet e tjera ndihmëse) dhe për dokumente arkivore 145€;
 - 1.3. Për materiale folklorike dhe leksikore, për përmbledhjen e Vjetarit dhe materialeve kompjuterike 30€;
 - 1.4. Për përgatitjen për shtyp të teksteve burimore (puna redaktoriale e veprave të përzgjedhura) 28€;
 - 1.5. Për indeksat e teksteve burimore 12€;
 - 1.6. Për përgatitjen për shtyp të botimeve dhe të teksteve të përkthyer 10€;
 - 1.7. Për përzgjedhjen dhe përgatitjen për shtyp të vargjeve 8€; dhe
 - 1.8. Për botime letrare në poezi 1.20€ për një varg;
 - 1.9. Për parathënien e katalogëve të ekspozitave 300 €.
2. Për çdo ribotim të veprës honorari i autorit zvogëlohet për 25%.
3. Për përpilimin e bibliografive dhe mbledhjen e teksteve ligjore e të kontratave, honorari paguhet sipas tarifës për materiale.
4. Për recensionet e dorëshkrimeve që dorëzohen për botim, secilit recensent i paguhet honorari i autorit prej 12€ për një tabak autori.
5. Për recensionet e kontributeve që botohen në revistat e Akademisë, recensentit i paguhet honorari i autorit në formë paushalli prej 30€ për secilin recension.
6. Për krahasimin e teksteve të shtypura 50€.
7. Për krahasimin e dorëshkrimeve 60€.
8. Për tabela kronologjike 9€, honorari nuk do të jetë më i vogël se 18€.
9. Për hartimin e bibliografive 1€ për kartelën e kompletuar bibliografike.
10. Për fjalorin shpjegues të fjalëve të panjohura 90€.

Neni 4

1. Kryesia e Akademisë cakton me vendim të veçantë paushallin, për:
 - 1.1. Mbledhjen dhe arkivimin e materialeve të ndryshme audio ose vizuale nga terreni.
 - 1.2. Përgatitjen grafike të librit, në rastet kur nuk kryhet nga shërbimet e Akademisë:
 - 1.2.1. Dizajn për botimet monografike;
 - 1.2.2. Dizajn për botimet artistike;
 - 1.2.3. Dizajn për katalogë;
 - 1.2.4. Dizajn për botimet enciklopedike;
 - 1.2.5. Kopertina;
 - 1.2.6. Fotografii; dhe
 - 1.2.7. Ilustrime.

Neni 5

1. Përkthyesve, për çdo tabak autori u paguhet:
 - 1.1. Për përkthim nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe 120 € (në raste të veçanta, me vendim të Kryesisë);
 - 1.2. Për përkthim nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj 140 € (në raste të veçanta, me vendim të Kryesisë);
 - 1.3. Për përkthim të vargjeve nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe, për një varg 0,80€; dhe
 - 1.4. Për përkthim të vargjeve nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj, për një varg 0,90€.
2. Redaktorëve të të gjitha përkthimeve në prozë e poezi u paguhet 30% të vlerës së honorarit për redaktimin e përkthimit.
3. Lektorëve për tekstet në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja për çdo tabak autori u paguhet 16€.
4. Krahasuesve / korrektorëve të teksteve në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja për çdo tabak autori u paguhet 3 €.
5. Redaktorit të botimeve i paguhet honorari prej 16€ për një tabak autori.
6. Kryeredaktorëve të revistave iu paguhet honorari prej 16€ për një tabak autori, ndërsa anëtarët e redaksisë paguhet sipas nenit 3, paragrafi 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

1. Përshkrimi i notave muzikore – muzikë serioze për një faqe paguhet:
 - 1.1. Për muzikë instrumentale – solo, piano, duo, trio, deri te orkestra kamerale 5 €;
 - 1.2. Për orkestër simfonike a2 - a3 5.80 €;
 - 1.3. Për muzikë vokale acappella 5.80 €; dhe
 - 1.4. Për muzikë vokalo-instrumentale 6.50 €;

Neni 7

1. Të gjitha honorarët e shënuar më sipër paguhet sipas rregullave financiare në fuqi.

Neni 8

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi honorarët e veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nxjerr më 21 mars 2017, nr. 266/3, nga Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Neni 9

1. Rregullorja hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë.

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja

